



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e mërkurë, në datën 06 shkurt 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Piro</b>	<b>MISHA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Zylyftar</b>	<b>BREGU</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Tv M Devolli” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv M Devolli”. **(Vendimi nr. 1, datë 06.02.2019);**
2. Rrëzimin e aplikimit të shoqërisë “Klobes” sh.p.k., për marrje autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Klobes”. **(Vendimi nr. 2, datë 06.02.2019);**
3. Rrëzimin e aplikimit të shoqërisë “Maqellara Tv Kabllor” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Maqellara”, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit” **(Vendimi nr. 3, datë 06.02.2019)**
4. Kalimin e të drejtave të licencës për transmetime audio analoge “Radio Klea” nga subjekti person fizik Taulant Pilavi, tek shoqëria “Radio Klea” sh.p.k. **(Vendimi nr. 4, datë 06.02.2019);**
5. Kalimin e të drejtave të licencës për transmetime audio analoge “Radio Lushnja” nga subjekti person fizik Edi Halilaj, tek shoqëria “Radio Lushnja” sh.p.k. **(Vendimi nr. 5, datë 06.02.2019);**
6. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Media Vizion” sh.a., licencuar për ofrimin e shërbimeve audiovizive për ndryshimin e logos. **(Vendimi nr. 6, datë 06.02.2019);**
7. Miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë së shoqërisë “MRM” sh.p.k., licencuar dhe autorizuar për ofrimin e shërbimeve audiovizive. **(Vendimi nr. 7, datë 06.02.2019);**
8. Azhornimin e zonës së ofrimit të shërbimit të disa subjekteve të pajisur me autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor. **(Vendimi nr. 8, datë 06.02.2019);**

9. Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Mikel Jaho, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Toshkëz”, për heqje dorë nga zona e ofrimit të shërbimit njësia administrative Kryeviidh **(Vendimi nr. 9, datë 06.02.2019)**;
10. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Emi Advertisement Co” sh.p.k., për ndryshimin e kushteve teknike të licencës së subjektit audio analog privat lokal “Radio Fantasy”(Vendimi nr. 10, datë 06.02.2019);
11. Miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Digicom” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit audioviziv të të tretëve, mbështetur në internet (IPTV) “Digicom”. **(Vendimi nr. 11, datë 06.02.2019)**;
12. Kalimin e të drejtave të autorizimit të lëshuar për subjektin person fizik Eltion Thanasi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor APT”, tek shoqëria “APT CABLE” sh.p.k. **(Vendimi nr. 12, datë 06.02.2019)**;
13. Miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë së shoqërisë “TIBO” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në internet (OTT) “TIBO”. **(Vendimi nr. 13, datë 06.02.2019)**;
14. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e vendimit, gjobë nr. 26, datë 17.09.2018, në masën 5,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit/apo AMA, ndaj shoqërisë “Johaniter – 2000” sh.p.k., për subjektin televiziv privat analog “Tv Johaniter”. **(Vendimi nr. 14, datë 06.02.2019)**;
15. Rrëzimin e kërkesës së subjektit person fizik z. Lartment Mato për rishikimin e vendimit nr. 155 datë 13.07.2018 të AMA-s, për lënien në fuqi të vendimit për gjobë nr. 10 datë 29.05.2018, në masën 5,000,000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit /apo AMA, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet IPTV pa autorizimin e AMA-s”. **(Vendimi nr. 15, datë 06.02.2019)**;
16. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e vendimit, gjobë nr. 25 datë 10.07.2018, në masën 5,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit/apo AMA ndaj shoqërisë “Ultranet” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur pa Autorizimin e AMA-s”. **(Vendimi nr. 16, datë 06.02.2019)**;
17. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e vendimit, gjobë Nr. 28, datë 14.11.2018, në masën 1,200,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit/apo AMA ndaj subjektit person fizik z. Altin Sharka, autorizuar për subjektin “Tv me kabëll Hysgjokaj”. **(Vendimi nr. 17, datë 06.02.2019)**;
18. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e vendimit, gjobë Nr. 29, datë 14.11.2018, në masën 1,300,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit/apo AMA” ndaj shoqërisë “Tata Junior” sh.p.k., autorizuar për subjektin “Tv me kabëll Tata Junior”. **(Vendimi nr. 18, datë 06.02.2019)**;
19. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit, gjobë Nr. 31, datë 14.11.2018, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit/apo AMA” ndaj subjektit person fizik z. Edi Tanushi, autorizuar për subjektin “Tv me kabëll Danja”. **(Vendimi nr. 19, datë 06.02.2019)**.

Tiranë, 6 shkurt 2019

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**